



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:071406

Datë: 01.10.2024

Numri i dokumentit: 06237538

P.nr.105/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË –Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona LAJQI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.Sh., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.I.nr.171/2021 të datës 13.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 02.09.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit A.Z., i pandehuri F.Sh., mbrojtësi i tij sipas autorizimit, Av.Sh.... S...., dhe i dëmtuari Sh.H., me datë 04.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 01.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.Sh., nga i ati I...., e ëma Xh....., e vajzërisë D...., i lindur me datë në V...., ku edhe tani jeton “...”, me vendbanim të përkoshëhm në Gj...., ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse,

Me datë, rreth orës minuta, në rrugën “K....”, gjegjësisht në shtëpinë e të dëmtuarit Sh.H.”, nr.153 në Mitrovicë së bashku kanë sulmuar personin tjetër dhe atë të dëmtuarin Sh.H., ashtu që të pandehurit pasi që kanë shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit për ti kërkuar paratë të cilat i dëmtuari ia kishte borxh shumë prej 7.000 euro të pandehurit D... R...., dhe posa del i dëmtuari në ballkon të shtëpisë, fillimisht fillojnë të fyen me fjalët me të pandehurit dhe anasjelltas dhe

pastaj të shtyhen me duar, ku i pandehuri F.Sh. e ka sulmuar fizikisht me dorë dhe pastaj e mban të dëmtuarin, ndërsa i pandehuri D..... R.... e sulmon të dëmtuarin duke e goditë me kondak të armës- revolës në kokë.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, e lidhur me nenin 184 paragrafi 2 lidhur me 31 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 452 dhe 462 të KPP-së, të akuzuarit, i:

S H Q I P T O N

- I.** DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Gjykata, në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 5 muajve ia zëvendëson me dënim me gjobë, ashtu që:

- II.** Obligohet i akuzuari që të paguajë gjobën në shumën prej 1000€ (njëmijë euro), të cilën gjobë është i obliguar të filloj ta paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I njëjti dënimin mund ta paguaj në tre këste të barabarta, ku pagesën e kështit obligohet ta paguaj më së largu deri me datë 5 të muajt vijues. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t`ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
- III.** I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim
- IV.** I dëmtuari Sh.... H....., për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.I.nr.171/2021 të datës 13.04.2022 kundër të pandehurit F.Sh., për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.09.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ajeten Zoni, i pandehuri F.Sh., mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokat Sh... S... dhe i dëmtuari Sh.H..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem. Tutje ka theksuar se është penduar për rastin e ndodhur, kërkim falje dhe premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Prokurori i Shtetit A.Z., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, i propozoj gjykatës që t'ia pranoj pranimin e fajësisë të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor, ashtu që me rastin e caktimit të matjes dhe llojit të dënimit që si rrethanë rënduese të merr parasysh dashjen e kryerjes së veprës penale, rrezikimin e vlerës së mbrojtur, shkallën e dëmit të shkaktuar, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, andaj nga të gjitha këto ti shqiptoj një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

I dëmtuari Sh.H., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, nuk pajtohet me pranimin e fajësisë dhe ka kërkuar që kjo procedurë ti bashkëngjitet lëndës tjetër, i bashkëngjitet ndjekëses penale dhe paraqet kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit F.Sh., avokat Sh.... S....., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se i propozoj gjykatës që t'ia pranoj pranimin e fajësisë të pandehurit, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pas konsultimit me të mbrojturin tim dhe i njëjti gjen mbështetje në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh një mori rrethana

lehtësuese sikurse janë: është hera e parë që bie ndesh me ligjin, më parë i pagjykuar, tani punon në Gjermani dhe është mbajtës i familjes, pendimin, kërkimi faljen, premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, sjellja korrekte e tij, pranimin i fajësisë dhe në mungesë të rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që të njëjti ti shqiptoj një dënim të kushtëzuar apo një dënim minimal me burg i cili do të shndërrohej në dënim me gjobë, për të cilin është i gatshëm të paguaj e me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër, i datës 28.03.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin Sh.H., i datës 28.03.2022; Procesverbali i marrje në pyetje për të dyshuarin D...R..., i datës 28.02.2022; Procesverbal për kontroll dhe sekuestrimin të përkohshëm, i datës 28.03.2022; Raporti i policit K.... S..., i datës 28.03.2022; Foto albumi me gjithsej 8 (tetë) fotografi; Procesverbal i marrjes së deklaratës për dëshmitaren I... H....., i datës 08.04.2022, Procesverbal i marrjes së deklaratës së të pandehurit D.... R.. , i datës 08.04.2022; Procesverbal i marrjes së deklaratës së të pandehurit F.Sh., i datës 08.04.2022; si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari F.Sh. ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim 6 muaj deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës. Gjykata, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, keqardhjen e shprehur për atë se çfarë ka ndodhur, dhe premtimin se nuk do të përsërisë më veprime të tilla. Ndërsa, si rrethana rënduese, gjeti shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprimet e paligjshme në të ardhmen.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462 të KPP-së ashtu që të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 452 dhe 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.105/2024, datë 01.10..2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Marigona LAJQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.